



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE
DEPARTAMENTI I FIZIKËS

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN - DEPARTAMENTI I FIZIKËS

Ref. nr. 4722

Prishtinë, Dt. 12. 11. 2025

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS
MASTER**

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Fizikë
Projektpropozimi	Kontrolli i Cilësisë (QC) në Radioterapi
Kandidati/ja	Diellëza Berisha
Mentori	Prof. Asoc. Gazmend Nafezi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 14.07.2025
	Vendimi nr. 2382

Dorëshkrimi i kandidates Diellëza Berisha fillon me një abstrakt, listën e figurave dhe tabelave dhe hyrjen. Në vazhdim kandidatja ka paraqitur rëndësinë e hulumtimit, metodologjitë e përdorura dhe rezultatet e pritura.

Materiali në kapitullin e parë përmban kryesisht aspektin teorik të punimit, duke filluar me strukturën e lëndës, modelet atomike dhe bërthamore, përshkrimin e llojeve të forcave, me theks të veçantë forcat bërthamore.

Kapitulli i dytë "Hyrje në rezatim", përshkruan llojet e ndryshme të rrezatimit, duke bërë klasifikimet e rrezatimit sipas orgjinës, aftësisë jonizuese, bashkëveprimeve të ndryshme dhe efektet përkatëse.

Kapitulli i tretë "Rezatimi në mjekësi", përshkruan metodat e matjeve të rrezatimit në mjekësi dhe saktësinë e tyre, duke u përqendruar në procedurat standarde të matjeve dhe ato të përdorura në këtë punim.

Materiali vazhdon me metodat e ndryshme të përdorura në imazheri dhe radioterapi, duke paraqitur rezultatet e arritura, duke përshkruar metodologjitë e përfshira në hulumtim, rezultatet

dhe diskutimet e rezultateve.

Punimi përmyllet me përfundimet e nxjerra nga rezultatet e arritura, disa rekomandime dhe krahasimet me standardet dhe protokollet ndërkombëtare.

Prandaj, duke u bazuar në përshkrimet e dhëna më lartë, dhe pas analizës së tërë materialit të punimit, komisioni për vlerësim të dorëshkrimit dhe mbrojte të temës master, bazuar në Kërkesën nr.4571, të datës 25.10.2025 për temën “**Kontrolli i Cilësisë (QC) në Radioterapi**” të kandidatës Diellëza Berisha, në përputhje me procedurat e rregullores së studimeve master, paraqet këtë:

Vlerësim të dorëshkrimit

Kandidatja Diellëza Berisha, temën e nivelit master e ka shkruar në përputhje me kriteret akademike dhe të parapara me Rregulloren për studime Master të Universiteti i Prishtinës me nr. 1/334, të datës 31.02.2023. Tërë materialin e ka përmbledhur në 79 faqe, të sistemuar në 4 kapituj. Materialit i paraprinë: deklarata e betimit, falënderimi, përmbajta, abstrakti, lista e tabelave dhe lista e figurave. Ndërsa përfundon më referencat. Kandidatja në hulumtim ka shfrytëzuar një numër të konsiderueshëm të literaturës aktuale, ndërsa për shtjellim të temës ka ndërtuar tabela dhe figura të shumta. Formulatat, tabelat dhe figurat janë kompatible me tekstin. Shtrimi dhe shtjellimi i temës është në përputhje me normat pedagogjike dhe hulumtuese. Komisioni mendon se me qëllim të rritjes së kualitetit të punimit, kandidatja duhet të bëjë edhe këto përmirësime:

1. Në kapitullin 3, nga 3.2.10 të jetë si kapitull i veçantë: Materiali dhe Metodatat
2. Rezultatet dhe diskutimet nuk përfshihen si kapitull, por pas kapitullit 4.
3. Referencat duhet të jenë me numra

Prishtinë, 12.11.2025

Komisioni:

1. 

Prof. Dr. Naim Sylja – kryetar

2. 

Prof. Asoc. Fisnik Aliaj – anëtar

3. 

Prof. Asoc. Gazmend Nafezi – anëtar (mentor)